

## Rezultate kryesore nga Anketa e Forcave të Punës 2012


Anketa e Forcave të Punës (AFP) është një vërtetim statistikor që kryhet pranë familjeve. Objektivi kryesor i AFP-së është mbledhja e informacionit për treguesit e tregut të punës që lidhen me strukturën e punësimit, papunësisë dhe popullsisë ekonomike jo-aktive. AFP mbulon popullsinë rezidente në Shqipëri.

### PUNËSIMI

Gjatë vitit 2012 në Shqipëri 65.5 përqind e popullsisë në moshë pune ishte aktive në tregun e punës. Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për femrat ishte 56.7 përqind ndërsa për meshkujt 74.4 përqind. Krahasur me vitin 2011, pjesëmarrja e femrave në tregun e punës është ulur me 3.6 përqind ndërsa pjesëmarrja e meshkujve është ulur me 1.7 përqind (shih Tab.1).

Për grupmoshën 15-29 vjeç, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës ishte 47.7 përqind (65.5 përqind e të rinjve 15-29 vjeç nuk ishin pjesëmarrës në tregun e punës për arsye se ata ishin duke ndjekur shkollën). Grupmosha 35-44 vjeç kishte shkallën më të lartë të aktivitetit ekonomik (81.5 përqind) për të dy gjinitë.

Shkalla e punësimit për popullsinë e moshës 15-64 vjeç për vitin 2012 ishte 56.4 përqind. Për meshkujt e kësaj grupmoshe shkalla e punësimit ishte më e lartë se për femrat. Me rritjen e moshës shkalla e punësimit vjen duke u rritur dhe më pas vjen në rënie për moshat mbi 55 vjeç.




**Tabela 1: Tregues bazë të tregut të punës 2011-2012**

Grup-mosha	Shkalla e punësimit		Shkalla e pjesëmarrjes në Forcat e Punës		Shkalla e papunësisë		Shkalla e papunësisë afatgjatë	
	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012
15 vjeç e lart	<b>51.9</b>	<b>50.2</b>	<b>60.0</b>	<b>57.9</b>	<b>13.6</b>	<b>13.4</b>	<b>9.9</b>	<b>10.4</b>
15-64	<b>58.7</b>	<b>56.4</b>	<b>68.2</b>	<b>65.5</b>	<b>13.9</b>	<b>13.9</b>	<b>10.2</b>	<b>10.8</b>
15-24	34.1	27.0	44.6	37.4	23.6	27.9	13.7	18.4
25-34	66.3	62.3	79.5	77.9	16.6	20.0	12.5	15.6
35-44	74.5	72.4	82.7	81.5	9.9	11.2	7.8	9.0
45-54	73.2	72.8	81.4	79.4	10.0	8.3	8.5	7.3
55-64	54.5	57.7	61.0	62.4	10.5	7.5	8.8	6.6
15-29	42.8	35.8	54.5	47.7	21.5	25.0	13.4	17.3
30-64	68.1	68.0	76.3	75.6	10.7	10.0	8.8	8.4
<b>Meshkuj</b>								
15 vjeç e lart	<b>58.6</b>	<b>56.7</b>	<b>67.6</b>	<b>66.3</b>	<b>13.4</b>	<b>14.5</b>	<b>9.7</b>	<b>10.9</b>
15-64	<b>65.6</b>	<b>63.2</b>	<b>76.1</b>	<b>74.4</b>	<b>13.8</b>	<b>15.0</b>	<b>10.0</b>	<b>11.3</b>
15-24	38.9	31.1	52.1	45.3	25.4	31.4	15.9	21.2
25-34	74.4	69.6	88.2	87.5	15.6	20.5	11.2	15.6
35-44	81.4	81.2	88.9	92.7	8.4	12.4	6.9	9.6
45-54	80.9	81.1	88.5	88.0	8.7	7.8	7.3	6.6
55-64	65.6	69.1	74.2	75.2	11.5	8.2	8.9	7.0
15-29	48.0	40.4	62.1	55.6	22.7	27.3	14.8	19.0
30-64	76.6	76.8	84.8	85.6	9.7	10.2	7.7	8.3
<b>Femra</b>								
15 vjeç e lart	<b>45.3</b>	<b>43.7</b>	<b>52.6</b>	<b>49.7</b>	<b>13.8</b>	<b>12.1</b>	<b>10.2</b>	<b>9.7</b>
15-64	<b>51.8</b>	<b>49.6</b>	<b>60.3</b>	<b>56.7</b>	<b>14.1</b>	<b>12.5</b>	<b>10.4</b>	<b>10.1</b>
15-24	29.0	22.5	36.7	28.8	20.9	21.9	10.2	13.6
25-34	58.3	54.8	70.9	68.1	17.8	19.4	14.0	15.6
35-44	68.3	66.3	77.1	73.7	11.5	10.1	8.8	8.5
45-54	65.7	64.2	74.3	70.6	11.6	9.0	9.8	8.3
55-64	43.4	44.0	47.6	47.0	9.0	6.2	8.7	5.9
15-29	37.3	30.8	46.5	39.1	19.8	21.4	11.5	14.8
30-64	60.0	59.6	68.2	66.0	11.9	9.7	10.0	8.6

Burimi i informacionit: Anketat e Forcave të Punës 2011 dhe 2012

Me rritjen e nivelit arsimor rritet dhe shkalla e punësimit, ku për të punësuarit me arsim deri në 8/9 vjeçar shkalla e punësimit ishte 53.5 përqind, për të punësuarit me arsim të mesëm 57.4 përqind dhe për personat me arsim të lartë 66.9 përqind (shih Fig.2).



**Struktura e punësimit sipas statusit në punësim.** Në vitin 2012, të punësuarit kundrejt një page përbënin 37 përqind të të punësuarve. Të vetë-punësuarit meshkuj (punëdhënës apo të vetëpunësuar pa të punësuar kundrejt një page) përbënin rreth 34 përqind të punësimit total të meshkujve, ndërsa femrat e vetë-punësuar përbënin 18 përqind të punësimit total të femrave.

**Tabela 2: Struktura e punësimit sipas statusit në punësim dhe gjinisë, 2011-2012**

(Përqindje sipas rreshtave)

	Të punësuar me page		Të vetëpunësuar dhe punëdhënës		Të vetëpunësuar pa të punësuar me		Punëtor pa pagesë i familjes		Gjithsej
	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012	
<b>MF</b>									
15-64	39.9	37.1	1.9	1.6	27.3	25.2	30.8	36.1	100
15-29	38.2	36.0	1.2	0.4	16.7	14.2	43.9	49.4	100
30-64	40.6	37.4	2.1	1.9	31.3	28.5	26.0	32.2	100
<b>Meshkuj</b>									
15-64	43.2	41.6	2.4	2.0	32.7	31.8	21.6	24.6	100
15-29	41.3	40.3	0.8	0.4	17.8	15.1	40.1	44.2	100
30-64	44.0	42.0	3.0	2.5	38.6	37.0	14.3	18.5	100
<b>Femra</b>									
15-64	35.8	31.3	1.2	1.0	20.5	16.9	42.5	50.8	100
15-29	34.0	30.0	1.7	0.4	15.1	12.9	49.2	56.7	100
30-64	36.4	31.7	1.0	1.2	22.4	18.0	40.1	49.2	100

Burimi i informacionit: Anketat e Forcave të Punës 2011 dhe 2012

Sipas të dhënave të AFP 2012, 50.8 përqind e femrave të punësuar ishin punëtorë pa pagesë të familjes, 31.3 përqind të punësuar kundrejt një page, dhe rreth 17 përqind të vetë-punësuar pa të

punësuar kundrejt një page. Ndërsa një në katër meshkuj të punësuar ishin punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes dhe 41.6 përqind ishin të punësuar me pagë.

**Struktura sektoriale e punësimit.** Sipas të dhënave të AFP 2012, rreth 30 përqind e personave të punësuar të moshës 15-64 vjeç (të punësuar me pagë dhe të vetëpunësuar) punuan në sektorin e shërbimeve.

Punësimi në sektorin e shërbimeve të tregut si tregtia, transporti, aktivitetet financiare, etj, përbënte 19 përqind të punësimit total, ndërsa në sektorin e shërbimeve jo të tregut punësimi zinte afro 11 përqind të punësimit total.

Në vitin 2012 punësimi në sektorin e bujqësisë përbënte 51.5 përqind të punësimit total. Ndër meshkujt e punësuar të moshës 15-64 vjeç 42.5 përqind e tyre punonin në sektorin e bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit, ndërsa ndër femrat e punësuar të po kësaj grupmoshe punësimi në këtë sektor përbënte 62.2 përqind të punësimit total të tyre (shih Tab.3).

**Tabela 3: Shpërndarja e të punësuarve sipas sektorëve të ekonomisë dhe gjinisë, 2011-2012**

(Përqindje sipas rreshtave)

	Bujqësi		Industri		Shërbimet e tregut		Shërbimet jo të tregut		Gjithsej
	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012	
<b>15-64 vjeç</b>	44.1	51.5	19.2	18.9	20.9	19.0	15.8	10.6	100
<i>Meshkuj</i>	36.9	42.5	25.2	26.5	23.6	23.3	14.3	7.7	100
<i>Femra</i>	53.3	62.2	11.6	9.8	17.5	14.0	17.7	14.0	100
<b>15-29 vjeç</b>	51.1	55.9	18.4	16.8	19.1	18.1	11.4	9.2	100
<i>Meshkuj</i>	44.7	47.6	24.4	23.5	21.7	22.9	9.2	6.1	100
<i>Femra</i>	59.9	66.9	10.1	8.0	15.6	11.8	14.4	13.3	100
<b>30-64 vjeç</b>	41.5	50.1	19.5	19.5	21.5	19.3	17.4	11.0	100
<i>Meshkuj</i>	33.8	40.8	25.5	27.6	24.3	23.4	16.3	8.2	100
<i>Femra</i>	50.9	60.8	12.2	10.3	18.1	14.6	18.8	14.2	100

Burimi i informacionit: Anketat e Forcave të Punës 2011 dhe 2012

Aktivitetet industriale si ndërtimi dhe industria nxjerrëse ishin sektorët ku dominojnë të punësuarit meshkuj ndërsa industria përpunuese mbetet një nga sektorët e mbizotëruar nga të punësuarat femra. E kundërta ndodh në sektorin e shërbimeve jo të tregut ku përqindja e femrave të punësuar ishte paksa më e lartë sesa përqindja e meshkujve të punësuar, kryesisht sepse femrat dominojnë në sektorët e arsimit dhe të shëndetësisë.

## PAPUNËSIA


Shkalla e papunësisë për popullsinë 15-64 vjeç në Shqipëri për vitin 2012 ishte 13.9 përqind (shih Tab.1). Shkalla e papunësisë afatgjatë e cila statistikisht përcaktohet nga një kohëzgjatje papunësie prej 12 muajsh e më shumë, në vitin 2012 ishte 10.8 përqind. Vihet re një rritje e shkallës së papunësisë së meshkujve me 1.2 përqind nga viti 2011 në 2012, ndërsa për femrat ky tregues është ulur me 1.6 përqind.

Për të rinjtë e moshës 15-29 vjeç ka një rritje të shkallës së papunësisë nga 21.5 përqind në vitin 2011 në 25 përqind në vitin 2012. E kundërta ndodh për grupmoshën 45-64 vjeç ku vihet re një rënie e shkallës së papunësisë si për meshkujt ashtu dhe për femrat.

Raporti i të rinjve 15-29 vjeç të papunë ndaj popullsisë së të njëjtës grupmoshë në vitin 2012, ishte mesatarisht 11.9 përqind.

Sipas përkufizimit ndërkombëtar për papunësinë, të rinjtë që po ndiqnin arsimin me kohë të plotë janë përfshirë në vlerësimin e papunësisë së të rinjve nëse ata ishin duke kërkuar punë në katër javët e fundit dhe ishin të gatshëm të fillonin punë brenda dy javëve të ardhshme.

Kurba e shkallës së papunësisë në Fig.3 fillon në një shkallë të lartë papunësie si për të rinjtë meshkuj ashtu edhe femra, dhe fillon të bjerë me rritjen e moshës. Të njëjtën sjellje shfaqin dhe kurbat e shkallës së papunësisë afatgjatë për të dy gjinitë.



Shumica e të papunëve u drejtohen të afërmve apo miqve/shokëve për të gjetur një punë. Kjo metodë e kërkimit për punë është e kombinuar dhe me aplikimin direkt tek një punëdhënës si dhe me vendosjen e lajmërimeve në gazeta, studimin e lajmërimeve për vende të lira pune në gazeta etj.

## POPULLSIA EKONOMIKISHT JO-AKTIVE

Popullsia ekonomisht jo-aktive përbëhet nga të gjithë personat të cilët nuk janë të punësuar apo të papunë. Rreth më shumë se një e treta e popullsisë ekonomisht jo aktive e moshës 15-64 vjeç në vitin 2012 deklaruan se ishin në arsim ose trajnim. Dy në tre të rinj të moshës 15-29 vjeç të klasifikuar si ekonomisht jo-aktivë gjatë periudhës së referencës ishin nxënës/studentë ose në trajnim. Rreth 17 përqind e popullsisë ekonomisht jo aktive të moshës 15-64 vjeç ishin duke përbushur detyrat shtëpiake. Ndër femrat e klasifikuara si ekonomisht jo-aktive, 26.4 përqind deklaruan që nuk ishin aktive në tregun e punës sepse po përbushnin detyrat shtëpiake. Ndërsa tek meshkujt, këtë status e kanë vetëm 0.2 përqind e tyre (shih Tab.4).

**Tabela 4 : Struktura e popullsisë (15-64 vjeç) ekonomisht jo-aktive, 2011-2012**

	2011			2012		
	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra
<b>Popullsia 15-64 vjeç</b>						
Në arsim ose trajnim	35.2	45.4	29.2	36.1	48.1	29.0
Në pension	12.5	9.9	14.0	10.3	8.7	11.3
Beson që nuk ka punë të disponueshme	12.9	14.3	12.1	11.4	11.8	11.2
Në paaftësi të përhershme	8.3	11.6	6.4	5.5	9.8	2.9
Duke përbushur detyrat shtëpiake	14.8	0.3	23.5	16.7	0.2	26.4
Tjetër	16.2	18.5	14.9	20.0	21.5	19.2
<b>Popullsia 15-29 vjeç</b>						
Në arsim ose trajnim	65.7	74	59.5	65.5	73.7	59.1
Në pension	0.1	0.1	0.1	0.1	0.2	0.1
Beson që nuk ka punë të disponueshme	7.2	8.2	6.5	6.9	6.7	7.1
Në paaftësi të përhershme	3.5	6	1.6	1.6	2.2	1.2
Duke përbushur detyrat shtëpiake	10.6	-	18.6	9.1	0.2	16.1
Tjetër	12.9	11.8	13.7	16.8	17.2	16.5
<b>Popullsia 30-64 vjeç</b>						
Në arsim ose trajnim	0.1	0.2	0.0	0.7	1.0	0.5
Në pension	26.8	25.5	27.4	22.6	24.3	22.0
Beson që nuk ka punë të disponueshme	19.5	24.1	17.5	16.8	21.2	15.1
Në paaftësi të përhershme	13.9	20.4	10.9	10.1	23.9	4.5
Duke përbushur detyrat shtëpiake	19.6	0.8	28.2	25.8	0.2	36.1
Tjetër	20.1	29.0	16.0	24.0	29.4	21.8

Burimi i informacionit: Anketat e Forcave të Punës 2011 dhe 2012

11.4 përqind e popullsisë ekonomisht jo-aktive deklaruan që nuk po kërkonin punë për arsye se besonin që nuk ka punë të disponueshme. Ndër të rinjtë e moshës 15-29 vjeç, 7 përqind e tyre klasifikohen si të papunë të dekurajuar ndërsa në popullsinë më të rritur të moshës 30-64 vjeç ky grup përbënte 16.8 përqind të popullsisë ekonomisht jo-aktive të kësaj grupmoshe. Ndërsa 10.3 përqind e popullsisë ekonomisht jo-aktive të moshës 15-64 vjeç ishin në pension dhe pak më shumë se 5.5 përqind ishin në paaftësi të përhershme.

## METODOLOGJI DHE DEFINICIONE

Anketa e Forcave të Punës është anketë që kryhet pranë familjeve. Masa e kampionit të zgjedhur për anketim ishte 5040 familje për çdo tremujor të vitit 2012. Zgjedhja ishte dy-hapëshe; në hapin e parë u zgjodhën zonat gjeografike dhe në të dytin familjet brenda këtyre zonave të zgjedhura me short.

Mbledhja e të dhënave në terren u shtri në të gjithë muajt e vitit 2012. Nga familjet e zgjedhura për t'u intervistuar, i'u përgjigjën pyetësorit të AFP-së 69 përqind e tyre. Në familjet e zgjedhura u anketuan nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë të gjithë pjesëtarët në moshë 15 vjeç e lart.

Nga ana metodologjike anketa plotëson kërkesat e EUROSTAT-it si ato që lidhen me përfaqësimin e kampionit, koeficientët e variacionit të treguesve kryesorë, hartimin e pyetësorit, si dhe me procedurat e peshimit të të dhënave.

Pyetësori i AFP-së është hartuar me asistencën teknike të EUROSTAT-it dhe ai është në përputhje të plotë me rekomandimet e EUROSTAT-it. Për klasifikimin e personave 15 vjeç e lart në kategoritë përkatëse në lidhje me pjesëmarrjen në tregun e punës u zbatuan definicionet e ILO dhe EUROSTAT.

**Të punësuar** janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës. Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës.

Të punësuar janë konsideruar edhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për arsye: (1) leje lindje, sëmundje lëndim apo paaftësi e përkoshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trainim të lidhur direkt me punën aktuale; (2) të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet që (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor sezonal ose (b) personi merr 50 përqind ose më shumë të pagës; (3) të vetëpunësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/fermën/praktikën profesionale; (4) punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak. Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetëkonsum, janë konsideruar të punësuar.

**Të papunë** konsiderohen personat që ishin:

- (a) *pa punë gjatë javës së referencës* (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi.
- (b) *aktualisht të disponueshëm për të punuar* (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës).
- (c) *duke kërkuar punë në mënyrë aktive* (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes

të tyrin) ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

Si hapa specifikë për të kërkuar punë konsiderohen:

- kontakt me një zyrë publike punësimi për të gjetur punë
- kontakt me një agjensi private punësimi për të gjetur punë
- aplikim direkt pranë ndonjë punëdhënësi
- kërkuar miqve/shokëve, të afërmeve, sindikatave etj.
- vendosur ose përgjigjur lajmërimeve në gazeta
- studiuar lajmërimet në gazeta
- marrë pjesë në një test apo intervistë
- kërkuar për tokë, godinë ose pajisje
- aplikuar për leje, liçenca ose burime financiare

**Popullsia në moshë pune** është popullsia 15-64 vjeç.

**Forca e Punës** përfshin personat e punësuar dhe të papunë.

**Popullsia ekonomisht jo aktive** përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, shtëpiakë, në shërbim të detyrueshëm ushtarak, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

**Niveli i punësimit** është raporti i të punësuarve 15-64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.

**Shkalla e papunësisë** është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

**Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës** është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.

Grupimi i seksioneve të NACE Rev1 në Tabelën 3:

- **Spektori i industrisë** përbëhet nga seksionet C-F (industria nxjerrëse; industria përpunuese; prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike, e gazit, e avullit dhe e ujit; ndërtimi).
- **Spektori i shërbimeve të tregut** përbëhet nga seksionet G-K (tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automobilave; hotele dhe restorantet; transportet, magazinimi dhe komunikacioni; ndërmjetësimi monetar dhe financiar; pasuritë e patundshme).
- **Spektori i shërbimeve jo të tregut** përbëhet nga seksionet L-Q (administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi shoqëror i detyruar; arsimi; shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale; aktivitete të tjera të shërbimit kolektiv, social dhe individual; shërbime në shtëpi; aktivitete të organizmave ndërkombëtare).